

LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 10: Janar - Mars 2023



Përshëndetje të nderuar prindër,

Edhe ky vit shkollor ka filluar e vijuar normalisht sipas gjithë udhëzimeve dhe strukturës së vitit shkollor 2022 – 2023 dhe sipas të gjithë planifikimeve vjetore të punës e të aktiviteteve të shkollës, për shumicën e të cilave ju jeni informuar.

Mësuesit dhe nxënësit tanë, krahas punës së përditshme mësimore-edukative, na kanë bërë krenarë me arritjet e tyre, si në testimet e dy periudhave, ashtu edhe me performancat e tyre artistike-kulturore e gjithashtu me arritjet e tyre në olimpiadën rajonale "Roke Shkencën", e atë ndërkombëtare "Kangur Linguistik".

Në olimpiadën "Roke Shkencën" shkolla jonë zuri vendin e dytë në nivel shkollash, me një diferencë pikësh shumë të vogël nga vendi i parë, dhe u rendit në tre vendet e para në secilën nga disiplinat e kësaj olimpiade.

Në olimpiadën "Kangur Linguistik" u shpallën 36 nxënës fitues nga 53 nxënës pjesëmarrës.

Njëkohësisht kanë vijuar të gjitha aktivitetet ekstra kurrikulare, të tilla si "Royal Ranger", "Përgjegjësia sociale", "Klubet e të nxënës", "Projekte sociale në ndihmë të njerëzve në nevojë", ekskursione, e aktivitete të ndryshme edukative e kulturore në nivel klase apo shkollë.

Krahas gjithë arritjeve, kemi pasur e kaluar edhe sfida të ndryshme në drejtim të disiplinës, respektimit të rregullores së shkollës. Gjëra për të cilat, në disa raste, na është dashur edhe të marrim masa disiplinore.

Së fundmi janë ushtruar në shkollë edhe kontrolle për mbajtjen nga nxënësit të telefonave celularë apo edhe mjeteve të tjera shpërqëndruese apo të palejuara në ambientet e shkollës. Në këtë pikë shohim

se ka vend për përmirësim edhe në drejtim të shkëpunimit me ju, pasi shpesh këto mjete bëhen pengesë për rritjen e cilësisë së punës mësimore-edukative dhe sjelljen e problematikave të ndryshme edukative mes nxënësve me njëri-tjetrin apo edhe mes nxënësve dhe mësuesve.

Të tjera sfida, aktivitete e punë na presin deri në mbylljen e këtij viti shkollor. Ftesa jonë për bashkëpunim më të ngushtë me ju, apo pjesëmarrjen tuaj në aktivitete të ndryshme në shërbim të nxënësve mbetet gjithnjë e hapur. Së bashku mund të ofrojmë një edukim e arsimim sa më cilësor për fëmijët tanë.

Me respekt,
Elona Rira
Drejtoreshë e Shkollës NEHEMIA

elona.rira@ng.team

AKTIVITETE

- Me fëmijët e kopshtit, mësueset kanë organizuar aktivitete me tematika të ndryshme, si p.sh.: "Vizatojmë natyrën"; "Japim e marrim dashuri me njëri-tjetrin"; "Mikrobet janë të vogla, shihen vetëm në mikroskop"; "Gëzuar 8 Marsin nëna të dashura".
- Nën kujdesin e infermieres, fëmijët e kopshtit kanë zhvilluar aktivitetin: "Si të kujdesemi për higjenën personale".
- Aktivitet i organizuar me fëmijët e kopshtit nga logopedia. "Mësojmë të shqiptojmë bukur tingujt dhe fjalët".
- Më 25 Shkurt 2023 u zhvillua olimpiada KANGAROO Linguistic në të cilin nxënësit ju nënshtruan një testi mbi njohuritë e përgjithshme që ata zotërojnë në gjuhën angleze. Nga 53 nxënës pjesëmarrës dolën fitues 36 nxënës.
- Psikologjia e Punës Sociale ka zhvilluar tema të ndryshme sensibilizuese me të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë. Tematikat e trajtuara kanë qënë: "Kreativiteti"; "Bullizmi, ndikimi i tij në rezultatet shkollore"; "Menaxhimi i stresit".
- Infermiera e Punës Sociale ka zhvilluar biseda informuese me nxënësit nga klasa e katër deri në klasën e dymbëdhjetë mbi zhvillimet që pëson trupi i njeriut gjatë pubertetit dhe adoleshencës.
- Aktivitet festiv për 7 - 8 Marsin. Nxënës të talentuar të shkollës shprehën falenderimet e tyre për punën e palodhur të mësuesve të shkollës tonë.
- Në kuadër të projektit "Policimi në komunitet" z. Haki Baçi ka trajtuar me nxënësit e klasës së gjashtë tematikën "Duhani, droga, alkooli".
- Nxënësit e shkollës NEHEMIA, Qeveria e Nxënësve në bashkëpunim me Projektin Social kanë përgatitur pako ushqimore për familjet në nevojë.
- Në vazhdimësi të Projektit "Përgjegjësia Sociale" nxënësit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë një herë në dy javë ndihmojnë dhe shërbejnë në punë të ndryshme si për shembull tek menca e shkollës, tek qendra "Drita e Shpresës", ferma, media, tek kopshti dhe klasa e tretë për pëmirësimin e njohurive të gjuhës gjermane dhe angleze.
- Nxënësit e klasave 8 – 11 kanë zhvilluar ekskursione mësimore- edukative në Korçë, në Tiranë duke u njohur me vlerat historiko-kulturore të vendit tonë.
- Edicioni 5 i Bursës së Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari tashmë është hapur. Kjo është një mundësi për të gjithë nxënësit e klasave të nënta nga rrethi i Pogradecit që duan të ndjekin studimet e gjimnazit në Shkollën NEHEMIA në Pogradec. Aplikimet mbyllen në datën 15 maj 2023.
- Në datën 17 mars u zhvillua faza e dytë e projektit B@S në të cilin grupet pjesëmarrëse prezantuan analizën mbi bizneset lokale që kishin përzgjedhur.
- Nxënësit e klasave të njëmbëdhjeta dhe të dymbëdhjeta morën pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të ditëve informative për Këshillim Karriere më 23.03.2023. Në këtë aktivitet ata u njohën me programet e ndryshme të studimit në Arsimin e Lartë.
- Nxënësit e 9-vjeçares dhe të gjimnazit kanë shprehur mendimet e tyre në lidhje me shërbimet e ndryshme që ofron shkolla në pyetësorin që u është vënë në dispozicion. Analiza e përgjigjeve të përfuara do shërbejë për të përmirësuar cilësinë e këtyre shërbimeve.
- Nxënësit janë fokusuar edhe në arrijtjet akademike, duke zhvilluar orë konsultimesh në lëndë të ndryshme për tu përgatitur sa më mirë për testimet e tremujorit të dytë.



I UROJMË MIRËSEARDHJEN

Vilma Galla

Vilma Galla ka përfunduar studimet e larta në Universitetin Fan. S. Noli në Korçë për mësuesi në Arsimin Fillor dhe Anglisht. Ajo tashmë punon në shkollën tonë si mësuese asistente në Arsimin Fillor.



Luisa Schwanzer

Luisa është 22 vjeç. Ajo vazhdon studimet e larta për mësuesi në Arsimin Fillor në Mynih. Praktikën profesionale po e zhvillon pranë shkollës tonë. Ajo njëkohësisht luan futboll në një klub futbollit në Mynih.

Lea Meier

Lea është 24 vjeç dhe vazhdon studimet e larta në Mynih për mësuesi në Arsimin Fillor. Vitin e ardhshëm ajo diplomohet dhe praktikën profesionale ka zgjedhur ta realizojë pranë shkollës tonë.



DATA TË RËNDËSISHME:

Takimi me prinderit për rezultatet e periudhës të dytë më 06.04.2023.

Faza e tretë e prezantimit të B@S është më 5 maj 2023. Gjate kësaj faze do të zgjidhet skuadra fituese e cila do vazhdojë garën me skuadrat e tjera në Vjenë.

Skano për të lexuar online!



Shkolla NEHEMIA

Nehemia 7304 Buçimas,
Pogradec Albania

Tel.: +355 83 600 403

Fax: +355 83 600 405

shkolla-nehemia@ng.team

Na ndiqni në facebook:

www.facebook.com/NehemiahGateway